



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.79, datë 28.12.2004

**PËR MIRATIMIN E “RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE
PËR MUAJIN NËNTOR TË VITIT 2004”**

Në mbështetje të nenit 43, shkronja “ç” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë “Raportin e Politikës Monetare për muajin nëntor të vitit 2004”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij raporti në : Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

BANKA E SHQIPËRISË

RAPORTI I POLITIKËS MONETARE

PËR MUAJIN NËNTOR 2004

DHJETOR 2004

Përmbajtja

I.	Zhvillimet kryesore të muajit	4
II.	Ecuria e inflacionit në muajin nëntor	5
II.1	Zhvillimet e përgjithshme në inflacion	5
II.2	Grupet kryesore të shportës së mallrave të konsumit	6
II.3	Faktorët që kanë ndikuar në inflacion	7
III.	Zhvillimet monetare dhe kërkesa për para	10
III.1	Politika monetare e Bankës së Shqipërisë	10
III.2	Ecuria e agregatëve monetarë	11
III.3	Kërkesa e ekonomisë për mjete monetare	13
III.3.1	Pozicioni valutator i sistemit bankar	13
III.3.2	Kërkesa e qeverisë për mjete monetare	14
III.3.3	Kredia për ekonominë nga sistemi bankar	14
IV.	Tregu i parasë dhe normat e interesit	17
IV.1	Ecuria e likuiditetit	17
IV.2	Ecuria e normave të interesit	17
IV.3	Kursi i këmbimit	20

I. ZHVILLIMET KRYESORE TË MUAJIT

- Inflacioni vjetor shënoi 2.2 për qind në muajin nëntor duke qenë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni mesatar vjetor ishte 3.0 për qind. Inflacioni mujor në muajin nëntor ishte 0.5 për qind.
- Kontributi kryesor në normën vjetore të inflacionit është dhënë nga grupi “qira, ujë dhe lëndë djegëse”, ndërkohë që indeksi i grupit “ushqime dhe pije joalkolike” është shfaqur në rënie në krahasim me një vit më parë, duke ushtruar presion për uljen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve.
- Rritja e çmimit ndërkombëtar të naftës, e reflektuar në rritjen e inflacionit vjetor të grupit “transport” nuk ka ndikuar dukshëm në inflacionin e përgjithshëm, kryesisht si pasojë e mbiçmimit vjetor të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros.
- Banka e Shqipërisë ka mbajtur të pandryshuar nivelin e normës bazë të interesit, në pritje të reagimit të bankave ndaj uljes së fundit të kryer në datën 11 nëntor. Ajo ka vazhduar të tërheqë likuiditetin e tepërt të sistemit me anë të ankandeve të repove.
- Norma vjetore e rritjes së ofertës monetare në muajin tetor rezultoi 9.7 për qind, duke shënuar një rënie të lehtë në krahasim me muajin e kaluar. Agregati M2 është rritur ngadalë si rezultat i kërkesës së ulët të qeverisë për para.
- Pozicioni valutor i sistemit bankar është përmirësuar gjatë muajit tetor. Gjatë këtij muaji është shënuar një rritje prej 20.1 milionë dollarësh në nivelin e mjeteve valutore neto.
- Deficiti buxhetor i krijuar gjatë muajit tetor është mbuluar pothuajse tërësisht nga financimi i brendshëm, i cili ka qenë rreth 1.9 miliardë lekë.
- Teprica e kredisë, në fund të muajit tetor të vitit 2004, arriti në 63.1 miliardë lekë, duke shënuar një rritje mujore prej 2.2 miliardë lekësh. Ekonomia shqiptare për periudhën dhjetor 2003 - tetor 2004 është kredituar me 12.4 miliardë lekë, duke përbërë rreth 76 për qind të nivelit të parashikuar në programin monetar për vitin 2004.
- Tendanca e lekut për nënçmim ndaj euros dhe mbiçmim ndaj dollarit është vërejtur edhe gjatë periudhës tetor – nëntor 2004. Gjatë periudhës tetor - nëntor 2004 leku është nënçmuar mesatarisht me 1.8 për qind kundrejt euros dhe është mbiçmuar mesatarisht me 4.1 për qind kundrejt dollarit.

II. ECURIA E INFLACIONIT NË MUAJIN NËNTOR

II.1 ZHVILLIMET E PËRGJITHSHME NË INFLACION


Muaji nëntor 2004 regjistroi një inflacion vjetor prej 2.2 për qind ndërkohë që inflacioni mesatar vjetor mbeti i pandryshuar, në nivelin 3.0 për qind. Norma vjetore e inflacionit rezultoi brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 2-4 për qind, duke qenë afër kufirit të poshtëm të këtij intervali. Duke filluar nga muaji shtator, i cili iu dha fund normave negative mujore të inflacionit¹, inflacioni mujor ka shënuar rritje, në përputhje me ecurinë sezonale të çmimeve gjatë tremujorit të katërt. Inflacioni mujor në muajin nëntor shënoi 0.5 për qind. Kjo normë ishte nën inflacionin mujor mesatar (0.7 për qind) të muajve nëntor, për periudhën 2000-2004.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).

	2000	2001	2002	2003	2004
Janar	-1.3	2.2	6.5	0.0	3.3
Shkurt	-1.3	1.5	7.6	1.1	4.4
Mars	-2.1	2.9	7.5	1.3	4.0
Prill	-1.4	3.0	6.5	2.3	3.2
Maj	-0.1	2.5	4.6	2.8	2.6
Qershor	0.1	4.0	3.7	2.6	2.9
Korrik	-1.3	5.6	4.2	3.0	3.1
Gusht	-0.7	4.1	5.5	3.0	2.7
Shtator	0.9	3.5	5.3	2.8	2.0
Tetor	1.8	1.8	5.8	2.9	2.0
Nëntor	1.9	2.8	3.7	3.4	2.2
Dhjetor	4.2	3.5	1.7	3.3	
Mesatar	0.1	3.1	5.2	2.2	3.0

Burimi: INSTAT

Grafik 1. Inflacioni vjetor (në përqindje).



Duke filluar nga muaji prill, inflacioni vjetor ka qenë në mënyrë të qëndrueshme brenda intervalit 2-3 për qind. Kjo qëndrueshmëri ka ardhur si rezultat i një situatë të favorshme makroekonomike, i kontrollit të komponentëve të kërkesës dhe i prodhimit të bollshëm bujqësor për vitin 2004.

¹ Inflacioni mujor ka shënuar vlera negative gjatë muajve maj, qershor, korrik dhe gusht.

II.2 GRUPET KRYESORE TË SHPORTËS SË MALLRAVE TË KONSUMIT

Gjatë muajit nëntor nuk janë vënë re ndryshime të dukshme në indekset e çmimeve të grupeve përbërëse të shportës dhe në kontributet e tyre në normën e përgjithshme të inflacionit vjetor. Megjithatë, në krahasim me muajin nëntor të vitit të kaluar, vihet re një ndryshim në kahun dhe madhësinë e kontributit të dy grupeve kryesore të shportës së konsumit. Inflacioni i grupit të qirasë e ka shtyrë lart normën e inflacionit vjetor, ndërkohë që grupi ushqimor ka ushtruar presion në drejtim të uljes së kësaj norme, për pjesën më të madhe të vitit.


Tabelë 2. Inflacioni vjetor i grupeve të shportës (në përqindje) dhe kontributi në normën vjetore totale (në pikë përqindjeje).

	Nëntor-03 (%)	Nëntor-04 (%)	Kontributi-03 (pp)	Kontributi-04 (pp)
Ushqim dhe pije joalkolike	4.8	-1.6	2.0	-0.7
Pije alkolike dhe duhan	5.1	1.8	0.2	0.1
Veshje koke dhe këmbë	-2.9	-2.9	-0.1	-0.1
Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	3.8	9.2	0.9	2.2
Mobilim, pajisje dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0.3	-0.8	0.0	0.0
Shëndeti	5.1	0.0	0.1	0.0
Transporti	2.5	4.1	0.1	0.2
Komunikimi	-1.7	15.4	0.0	0.2
Argëtimi dhe kultura	0.5	1.4	0.0	0.0
Shërbimi arsimor	8.3	6.7	0.1	0.1
Hotele, kafene dhe restorante	2.2	3.3	0.2	0.3
Mallra dhe shërbime të ndryshme	-2.2	-0.6	-0.1	0.0
Totali	3.4	2.2	3.4	2.2

Burim: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.


Konkretisht, në muajin nëntor, grupi "ushqim dhe pije alkoolike" ka shënuar rënie të çmimit në bazë vjetore për të shtatin muaj radhazi. Kontributi i inflacionit të këtij grupi në inflacionin total vjetor ishte negativ dhe i ndjeshëm; -0.7 pikë përqindjeje. Për krahasim, në muajin nëntor të vitit të kaluar, ky grup kontribuoi me 2.0 pikë përqindjeje, duke sjellë më shumë se gjysmën e normës vjetore të inflacionit. Nga ana tjetër, pothuajse gjatë gjithë vitit 2004 është vënë re rritje e dukshme e kontributit të inflacionit të grupit "qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë në fillim të këtij viti. Inflacioni vjetor i këtij grupi, në muajin nëntor (9.2 për qind), ka kontribuar me 2.2 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit, ndërkohë që shuma e kontributeve të grupeve të tjera ka qenë zero.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Inflacioni i grupit “transport” për muajin nëntor ishte 4.1 për qind, duke iu afuar normës më të lartë vjetore të regjistruar gjatë këtij viti, asaj të muajit gusht. Nëngrupi “shërbime ndaj mjeteve personale të transportit” shënoi një normë vjetore prej 9.3 për qind, duke pasqyruar rritjen e çmimit të naftës në vendin tonë. Pavarësisht se çmimi mesatar i naftës në tregun ndërkombëtar, gjatë muajit nëntor, ishte 5 për qind më i ulët se gjatë muajit tetor, nafta në tregun vendas regjistroi rritje çmimi. Kjo rritje, ashtu si edhe ajo e muajit gusht, ka ndjekur rritjen në tregun ndërkombëtar me një muaj vonesë. Megjithatë, rritja prej 4.1 për qind e inflacionit vjetor të grupit “transport”, për shkak të peshës së vogël në shportën e çmimeve të konsumit (4.8 për qind), ka kontribuar me vetëm 0.2 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit në nëntor.

Grafik 3. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).




Grupi “komunikim” ka shënuar një normë vjetore inflacioni prej 15.4 për qind, duke kontribuar me 0.2 pikë përqindjeje në inflacionin e përgjithshëm. Kontributi i inflacionit të këtij grupi në inflacionin e përgjithshëm ka shënuar rënie të theksuar në krahasim me tremujorin e parë të këtij viti (shiko grafikun 2). Rritja e tarifave të telefonisë fikse në muajin dhjetor të vitit 2003, ka ndikuar në rritjen e inflacionit të grupit “komunikim”, me gjithë uljen e tyre të mëvonshme në muajin prill.

II.3 FAKTORËT QË KANË NDIKUAR NË INFLACION


Ambienti i favorshëm makroekonomik, si në anën e ofertës ashtu edhe në atë të kërkesës, si dhe mungesa e faktorëve shock kanë ndikuar në ruajtjen e vazhdueshme të normës vjetore të inflacionit brenda intervalit të synuar 2-4 për qind. Shpenzimet buxhetore kanë qenë më të ulta se parashikimi për nëntëmuajorin e parë. Kështu, deri në muajin tetor, shpenzimet buxhetore u realizuan në masën 90.1 për qind ndaj planifikimit mujor dhe 69.0 për qind ndaj atij vjetor. Duke qenë brenda kuadrës të programuar të politikave ekonomike për vitin 2004, ato nuk kanë ushtruar presione inflacioniste as në muajin nëntor të këtij viti. Gjithashtu, norma e rritjes vjetore të shpenzimeve korente ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme gjatë vitit 2004.

Grafik 4. Norma e rritjes vjetore të shpenzimeve buxhetore.



Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, megjithë uljet e vazhdueshme të normave të interesit, ka mbajtur nën kontroll agregatët monetarë. Normat vjetore të rritjes së agregatëve monetarë M1 dhe M3, kanë rezultuar nën trendin historik për muajin tetor.

Grafik 5. Rritja vjetore e M1 real.



Nga ana e ofertës, një numër faktorësh kanë ushtruar presion për rënien e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në ekonomi. Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, prodhimi bujqësor, prodhimi i degës së agroindustrisë dhe i degës së peshkimit në vitin 2004 kanë qenë më të lartë se gjatë vitit të kaluar dhe, njëkohësisht, më të lartë se parashikimi i fillimit të vitit. Norma e rishikuar e rritjes vjetore të prodhimit bujqësor është 3.8 për qind nga 2.8 për qind e parashikuar në fillim të vitit. Prodhimi i bollshëm bujqësor ka bërë që të rritet oferta e prodhimeve vendase në tregun e brendshëm, gjë që ka shkaktuar uljen e çmimeve të një numri produktesh ushqimore dhe kryesisht të frutave dhe perimeve. Rritja e prodhimit në sektorin e bujqësisë është favorizuar nga kushtet e përshtatshme klimaterike si edhe nga rritja e investimeve në degën e

agroindustrisë gjatë viteve 2003 dhe 2004. Efekti sezonal i daljes në treg të prodhimit vendas ka shkaktuar, nga muaji prill deri në muajin gusht, rënie mujore të shprehur në norma negative të inflacionit të grupit ushqimor. Ky efekt ka qenë i pranishëm çdo vit por, në vitin 2004, ai është shfaqur më shpejt dhe ka zgjatur më shumë.

Mbiçmimi vjetor i lekut ndaj euros dhe dollarit², i kombinuar me stabilitetin e inflacionit në vendet partnere, ka ndikuar në zbutjen e presioneve inflacioniste që vijnë nga çmimet e importit të mallrave të konsumit dhe të lëndëve të para. Forcimi i lekut ka shërbyer si amortizues i presioneve që rritja e çmimit të naftës mund të sillte në tregun e brendshëm, si në rritjen e drejtpërdrejtë të çmimit të këtij produkti, ashtu dhe në rritjen e kostove të shërbimeve apo të mallrave të lidhura me të.

Tabelë 3. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje).

	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
Greqi	2.9	3.1	3.1	3.0	3.1	2.8	2.9	3.3
Itali	2.3	2.3	2.3	2.4	2.2	2.4	2.1	2.1

Burimi: Eurostat News Release.

Gjithashtu, situata e përmirësuar energjitike, e shprehur në rritjen e prodhimit të energjisë, në rënien e importeve dhe në rritjen e konsumit nga ana e përdoruesve jofamiljarë, ka ulur koston e zëvendësimit të burimeve të vazhdueshme të energjisë me burime alternative si gjeneratorët. Rritja e çmimit të administruar të energjisë elektrike në fillim të këtij viti nuk ka çuar në pakësimin e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar nga firmat prodhuese. Sasia e energjisë elektrike, e përdorur nga këta konsumatorë gjatë nëntëmuorit të parë të këtij viti, ka qenë rreth 20 për qind më e lartë sesa vjet.

Analiza e faktorëve të kërkesës dhe ofertës tregon se zhvillimet e tyre, në mungesë të faktorëve *shock*, do të favorizojnë ruajtjen e inflacionit brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë edhe për periudhën në vazhdim.

² Mbiçmimi vjetor i lekut ndaj dollarit dhe euros gjatë muajit nëntor ka qenë përkatësisht 14.9 dhe 5.7 për qind.

III. ZHVILLIMET MONETARE DHE KËRKESA PËR PARA

III.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë ka vijuar të ruajë një kah zbutës të politikës monetare gjatë gjysmës së dytë të vitit 2004. Kjo politikë është kushtëzuar nga qëndrueshmëria e treguesve makroekonomikë dhe zhvillimet pozitive në treguesin e inflacionit. Duke filluar nga muaji mars, inflacioni ka qenë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe parashikimet kanë qenë vazhdimisht optimiste për respektimin e objektivit për vitin 2004. Në të njëjtën kohë, një zhvillim i spikatur i vitit 2004 ka qenë rritja e besimit të publikut në sistemin bankar, e shprehur në rritjen e besimit dhe të kërkesës për lekë. Të dy këta faktorë kanë mundësuar ndjekjen e një politike monetare zbutëse gjatë vitit 2004, pa çënuar ekuilibrat dhe raportet monetarë.

Banka e Shqipërisë ka ulur pesë herë normën e saj bazë të interesit³, e ndjekur kjo nga ulje të normave të interesit të tregut ndërbankar, të depozitave në lekë dhe të bonove të thesarit. Gjithashtu, edhe normat e interesit të kredive në lekë kanë pësuar përgjithësisht një ulje sipas afateve të maturimit, por zhvendosja e strukturës së tyre drejt afateve më të gjata ka ndikuar në rritjen e normës mesatare të ponderuar të interesit. Niveli i normave reale të interesit ka kontribuar në ruajtjen e ekuilibrave monetarë dhe garantimin e një situatë të qëndrueshme likuiditeti në sistem. Agregatët monetarë kanë vijuar të jenë të kontrolluar dhe struktura e tyre është zhvendosur drejt afateve më të gjata të maturimit (shiko grafikët 7 dhe 8).

Kursi i këmbimit të lekut kundrejt dollarit dhe euros ka vijuar të mbiçmohet gjatë vitit 2004, megjithë uljen e përgjithshme të normave të interesit. Ky mbiçmim ka reflektuar kryesisht rritjen e kërkesës për lekë, si pasojë e diferencës së normave të interesit midis lekut dhe valutës. Nga ana tjetër, rritja e prodhimit të brendshëm bujqësor dhe përmirësimi i situatës energjitike kanë ndikuar në uljen e importeve, duke reduktuar kërkesën për valutë. Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun valutor gjatë vitit 2004, sidomos në periudhën e verës, për të balancuar raportin kërkesë-ofertë dhe për të injektuar likuiditet në treg. Ndërkohë, presionet mbiçmuese të lekut kanë shënuar zbutje pas kësaj periudhe dhe aktiviteti i Bankës së Shqipërisë në tregun valutor është zvogëluar mjaft gjatë periudhës tetor-nëntor.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të tërheqë likuiditet nga sistemi gjatë dy muajve të fundit, duke përdorur instrumentin e marrëveshjeve të riblerjes gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, ajo ka respektuar objektivat e saj sasiore, në kuadrin e marrëveshjes PRGF.

Tabelë 4. Realizimi i objektivave sasiore të Bankës së Shqipërisë.

	Dhjetor '03	Mars 04	Qershor 04	Shtator '04	Tetor '04
Rezerva ndërkombëtare neto (në milionë dollarë)					
Objektivi	715.8	751.8	765.8	923.7	929.7
Aktuale	832.7	827.6	961.5	1043.6	1049.4
Diferenca	116.8	75.8	195.7	119.9	119.7
Mjetet e brendshme neto (në miliardë lekë)					
Objektivi	96.0	83.0	85.0	70.0	72.0
Aktuale	72.0	66.4	54.7	55.4	55.3
Diferenca	-24.0	-16.6	-30.3	-14.5	-16.6


³ Banka e Shqipërisë ndërmori uljen e fundit të normës bazë të interesit në datën 4 nëntor.

Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)					
Objektivi	280.9	272.8	270.1	279.1	280.8
Aktuale	266.8	272.6	263.6	272.0	273.0
Diferenca	0.0	-0.2	-6.5	-7.1	-7.8

III.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË


Norma vjetore e rritjes së ofertës monetare në muajin tetor rezultoi 9.7 për qind, duke shënuar një rënie të lehtë në krahasim me muajin e kaluar. Kjo ecuri ka reflektuar rritjen e ngadaltë të agregatit M2 si edhe rritjen më të ulët të depozitave në valutë për shkak të mbiçmimit të lekut gjatë muajit tetor. Rritjet relative të përbërësve të ofertës monetare kanë qenë të balancuara, duke bërë që struktura e saj kohore dhe valutore të qëndrojë në ekuilibër.

Grafik 6. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.



Niveli i parasë jashtë bankave ka shënuar një rritje mujore prej 0.4 miliardë lekësh ose 0.3 për qind në muajin tetor. Në përputhje me tendencën rritëse të saj në gjashtëmujorin e dytë të vitit, norma e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave arriti në 4.9 për qind nga 4.1 për qind që ishte një muaj më parë. Kjo rritje përfaqëson kryesisht një tendencë përafrimi me normat e rritjes vjetore të përbërësve të tjerë të ofertës monetare, në kushtet e ruajtjes në ekuilibër të strukturës kohore të ofertës monetare. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare shënoi vlerën 25.9 për qind, duke mbetur i pandryshuar nga niveli i një muaji më parë. Prej disa muajsh ky raport ka shfaqur një tendencë stabilizimi.

Grafik 7. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real.



Kontributi i depozitave në lekë në rritjen e ofertës monetare në muajin tetor ka rezultuar i ulët. Niveli i tyre shënoi një rritje mujore prej 0.5 miliardë lekësh ose 0.2 për qind, ndërsa norma vjetore e rritjes së depozitave në lekë në muajin tetor zbriti në 10.4 për qind, nga 12.1 për qind që ishte në muajin shtator. Kjo ecuri ka reflektuar ngadalësimin e rritjes së agregatit M2 si rezultat i kërkesës së ulët të qeverisë për para, ndërkohë që kredia në lekë ka shënuar një rritje të kënaqshme mujore. Struktura kohore e depozitave në lekë është zhvendosur drejt depozitave me afat, të cilat kanë shënuar një rritje mujore prej 2.6 miliardë lekësh ose 1.2 për qind. Ecuria në rënie e inflacionit ka ruajtur nivele të kënaqshme të normave reale të interesit, duke favorizuar rritjen e depozitave me afat në lekë.

Rënia e depozitave pa afat në lekë dhe rritja e ulët e parasë jashtë bankave kanë çuar në rënie e agregatit M1. Norma e rritjes vjetore të këtij treguesi në muajin tetor zbriti në 7.6 për qind, nga 8.8 për qind që ishte një muaj më parë. Gjithashtu, norma e rritjes vjetore të bazës monetare shënoi vlerën 6.6 për qind, duke mbetur nën mesataren historike të viteve të shkuara.

Rritja e depozitave në valutë në muajin tetor rezultoi 0.3 miliardë lekë ose 0.3 për qind. Mbiçmimi rezultat i lekut ndaj valutave euro dhe usd vlerësohet të ketë ndikuar negativisht rritjen mujore të tyre me rreth 0.26 miliardë lekë. Ritmi vjetor i rritjes së depozitave në valutë në muajin tetor është rritur në 13.7 për qind nga 12.1 për qind që ishte në muajin shtator, duke reflektuar reduktimin e efektit negativ të mbiçmimit vjetor të lekut në krahasim me muajin e kaluar. Në mungesë të këtij mbiçmimi, norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë paraqitet e qëndrueshme në nivelin 25.4 për qind. Raporti i depozitave në valutë ndaj agregatit M3 ka mbetur i pandryshuar, si rezultat i rritjeve mujore të përafërta të përbërësve në lekë dhe në valutë të ofertës monetare.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve monetarë në muajin tetor (në miliardë lekë).


	Tetor	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2004	absolut	përqindje	absolut	përqindje
Para jashtë bankave	126.6	0.4	0.3	6.0	4.9
Depozita totale	362.2	0.9	0.2	37.1	11.4
- në lekë	246.1	0.5	0.2	23.1	10.4
- në valutë	116.1	0.3	0.3	14.0	13.7
Depozita pa afat	69.9	-2.5	-3.5	9.3	15.3
- në lekë	25.7	-2.1	-7.4	4.8	22.9
- në valutë	44.2	-0.5	-1.0	4.5	11.3
Depozita me afat	292.3	3.4	1.2	27.8	10.5
- në lekë	220.3	2.6	1.2	18.3	9.1
- në valutë	72.0	0.8	1.1	9.5	15.2
M1	152.4	-1.7	-1.1	10.8	7.6
M2	372.7	0.9	0.2	29.1	8.5
M3	488.8	1.3	0.3	43.1	9.7
Baza monetare	167.0	0.5	0.3	10.3	6.6

III.3 KËRKESA E EKONOMISË PËR MJETE MONETARE

III.3.1 Pozicioni valutor i sistemit bankar


Mjetet valutore neto të sistemit bankar janë rritur⁴ me 20.1 milionë dollarë në muajin tetor. Rritja në terma vjetorë e mjeteve valutore neto ka dhënë një kontribut prej 68.3 për qind në rritjen vjetore të M3 në muajin tetor, kontributi ky më i lartë i dhënë gjatë vitit 2004. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto të shprehura në lekë janë ulur me rreth 1.6 miliardë lekë.

Grafik 8. Kontributi i rritjes vjetore të MVN-së në rritjen vjetore të M3.



Rritja mujore e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë ishte 27.3 milionë dollarë. Mbiçmimi i euros kundrejt dollarit në tregun ndërkombëtar ka qenë faktori kryesor i kësaj rritjeje. Ky mbiçmim, i cili në terma mujorë ishte 2.6 për qind, ka ndikuar në rritjen e mjeteve valutore neto me 19.8 milionë dollarë. Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun valutor në muajin tetor por disa transaksione me qeverinë ose për llogari të saj kanë ndikuar në rritjen e rezervës së Bankës së Shqipërisë. Mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë janë ulur me 7.2 milionë dollarë në muajin tetor.

Grafik 9. Mjetet valutore të sistemit bankar (në milionë usd).




⁴ Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit mjetet valutore rezultojnë me ulje rreth 10.4 milionë dollarë.

III.3.2 Kërkesa e qeverisë për mjete monetare.

Deficiti buxhetor ka shënuar rritje në muajin tetor. Në terma mujorë, deficiti buxhetor është rritur me 1.6 miliardë lekë duke arritur në nivelin 15.3 miliardë lekë. Kërkesa e qeverisë është mbuluar pothuajse tërësisht nga financimi i brendshëm, i cili ishte rreth 1.9 miliardë lekë në muajin nëntor. Bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet blerjeve të obligacioneve qeveritare, kanë kontribuar me 1.2 miliardë lekë në këtë financim. Financimi i kërkesës së qeverisë me bono thesari, rreth 0.5 miliardë lekë, është mundësuar nga blerjet e individëve dhe të institucioneve. Kalimi i një pjese të të ardhurave nga privatizimi i Bankës së Kursimeve (0.1 miliardë lekë) si dhe konvertimi i fondeve të Bankës së Kursimeve për borxhin e jashtëm (0.1 miliardë lekë), kanë qenë gjithashtu pjesë e financimit të brendshëm.

Grafik 10. Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



III.3.3 Kredia për ekonominë nga sistemi bankar

Teprica e kredisë, në fund të muajit tetor të vitit 2004, arriti në 63.1 miliardë lekë, duke shënuar një rritje mujore prej 2.2 miliardë lekësh. Në ndryshim nga zhvillimet në tregun e huadhënies bankare të një muaji më parë, muaj në të cilin teprica e kredisë nuk shënoi rritje, muaji tetor vlerësohet si një ndër muajt me rritje më të lartë në nivel mujor gjatë vitit 2004. Ekonomia shqiptare për periudhën dhjetor 2003 - tetor 2004 është kredituar me 12.4 miliardë lekë duke përbërë rreth 76 për qind të nivelit të parashikuar në programin monetar për vitin 2004. Në rritjen e tepricës së kredisë për periudhën në fjalë, nuk duhet mënjanuar efekti i kursit të këmbimit. Mbiçmimi i lekut ndaj dy monedhave usd dhe euro, respektivisht me 6.8 për qind dhe 5.8 për qind, ka ndikuar negativisht në uljen e tepricës së kredisë me 3.5 miliardë lekë. Duke e marrë në konsideratë këtë efekt, rritja reale e tepricës së kredisë është rreth 16 miliardë lekë, pothuajse i barabartë me nivelin e parashikuar në programin monetar për vitin 2004, 16.4 miliardë lekë.

Ecuria e shumë treguesve të aktivitetit kreditues gjatë muajit tetor vlerësohet pozitive. Këtë fakt e konkretizojnë më së miri vlerat gjithnjë në rritje të rapoteve të tilla si kredi për ekonominë ndaj PPB-së, raporti kredi/depozita si dhe raporti kredi ndaj totalit të aktiveve.

Tabelë 6. Ecuria e disa treguesve kryesorë⁵.

	2002	2003	2004			
			T-1	T-2	T-3	Tetor'04
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	456.0	458.2	487.6	488.8
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	71.6	69.5	67.4	67.7
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	59.9	57.1	54.8	54.8
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	11.7	12.4	12.6	12.9
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	13.7	14.6	14.7	15.3
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	5.7	6.8	7.0	7.4	7.3	7.6
Depozita gjithsej (në % ndaj PBB)	42.2	43.4	44.1	44.1	44.4	44.0
Raporti kredi/depozita (në %)	13.5	15.7	15.8	16.7	16.9	17.4

Struktura e kredisë sipas afateve, edhe gjatë muajit tetor, vazhdon të jetë më e orientuar drejt kredisë afatmesme dhe asaj afatgjatë, duke iu përgjigjur gjithnjë e më shumë nevojave të vendit për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve podhuese. Gjithashtu, edhe struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave (lekë/valutë) po shënon përmirësime në favor të rritjes së kredisë në lekë, edhe pse raporti i tyre lë për të dëshiruar (18 për qind e tepricës së kredisë është në lekë dhe 82 për qind e saj është në valutë).

Tabelë 7. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë (në përqindje).

	2002	2003	T-1 '04	T-2' 04	T-3 '04	Tetor '04
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	53.4	56.8	60.9	63.1
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	41.6	35.4	34.0	33.0
Kredi afatmesme	30.1	33.3	35.4	37.8	37.0	38.0
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	23.0	26.8	29.0	29.0
Lekë	21.3	19.6	17.0	17.0	17.0	18
Valutë	73.7	80.4	83.0	83.0	83.0	82

Kredia afatmesme dhe afatgjatë përbën 42 për qind të kredisë së re të lëvruar gjatë muajit shtator. Muaji shtator ka shënuar një zhvillim pozitiv për sa i përket strukturës vakutore të kredisë së re të akorduar. Gjatë këtij muaji, kredia e re në lekë ka përbërë 39 për qind të totalit të kredisë së re, duke qenë 6 pikë përqindjeje më e lartë se një muaj më parë dhe mjaft më e lartë në krahasim me nivelet historike prej 25 për qind.

Gjatë muajit tetor janë lëvruar 7.5 miliardë lekë kredi të reja ose rreth 32 për qind më shumë se një muaj më parë. Kredia e re, e lëvruar gjatë dhjetë muajve të parë të vitit, arriti në 81.8 miliardë lekë, duke qenë rreth 16 për qind më e lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Lëvrimi i kredive të reja afatmesme dhe afatgjata ka shënuar një rritje në masën 40 për qind krahasuar me vitin 2003. Përmirësime janë shënuar edhe në drejtim të kredisë së re të lëvruar në lekë, e cila ka qenë rreth 50 për qind e kredisë së re të lëvruar në muajin tetor në krahasim me 32 për qind që ka qenë gjatë nëntë muajve të parë.

⁵ Ky raport është ndërtuar ndaj PBB në nivel vjetor për vitin 2004.

Tabelë 8. Ecuria e kredisë së re në vite (në miliardë lekë).


	2002	2003	T-1 '04	T-2'04	T-3 '04	Tetor '04
Kredi e re (në mld lekë)	62.6	92.6	27.9	28.5	18	7.4
Kredi afatshkurtër	44.7	63.1	18.7	18.1	10.9	4.7
Kredi afatmesme	13	22.2	5.7	6.8	3.9	1.7
Kredi afatgjatë	4.8	7.4	3.5	3.6	3.1	1.1
Lekë	20.8	30.8	8.8	8.9	6.0	3.6
Valutë	41.8	61.8	19.1	19.6	12	3.8

IV. TREGU I PARASË DHE NORMAT E INTERESIT

IV.1 ECURIA E LIKUIDITETIT

Gjatë muajit nëntor, sistemi bankar rezultoi me tepriçë likuiditeti disi më të lartë se në muajin tetor. Niveli mesatar i likuiditetit në muajin nëntor shënoi shifrën 4.5 miliardë lekë. Ecuria e tij është diktuar kryesisht nga ecuria e financimit të deficitit buxhetor në muajin nëntor.

Grafik 11. Likuiditeti i sistemit bankar pranë Bankës së Shqipërisë⁶ (në miliardë lekë).



Për tërheqjen e likuiditetit të tepërt, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të përdorë instrumentin e repos njëjavore me çmim fiks. Pjesëmarrja në ankandet e repos ka shënuar të njëjtat rezultate me ato të muajit tetor dhe zë peshën më të madhe në likuiditet. Likuiditeti i tërhequr me anë të depozitës njëditore ka rezultuar në nivele më të ulëta se një muaj më parë. Në depozitë njëditore janë investuar mesatarisht 0.3 miliardë lekë ose 1.2 miliardë lekë më pak.

Krahasuar me një muaj më parë, aktiviteti i tregut ndërbankar ka ruajtur pothuajse të njëjtin nivel. Vëllimi mesatar ditor i transaksioneve të kryera në muajin nëntor regjistroi vlerën 0.62 miliardë lekë ose 0.14 miliardë lekë më pak se një muaj më parë.

Kërkesa e qeverisë për financim nga sistemi bankar është ulur krahasuar me një muaj më parë. Në të gjitha rastet, oferta e bankave për të investuar në bono thesari të qeverisë ka qenë më e lartë sesa kërkesa e qeverisë dhe e përqendruar në bonot e thesarit për afate gjashtëmuajore e dymbëdhjetëmuajore. Kjo ka çuar në një rritje të konkurrencës për to dhe uljen e *yield*-it përkatës.

IV.2 ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Në përgjigje të sinjaleve të politikës monetare⁷, bankat kanë reaguar duke ulur normat e interesit në tregun e depozitave në lekë, në tregun primar, në tregun ndërbankar dhe në tregun e kredive në lekë. Reagimi i interesave në tregun ndërbankar ka qenë i menjëhershëm por jo i qëndrueshëm. Normat e interesave janë luhatur në varësi të raportit kërkesë-ofertë. Në fund të

⁶ Përfshin marrëveshjet e repos, depozitat njëditore dhe rezervat e tepërta pranë Bankës së Shqipërisë.

⁷ Ulja e fundit e normës bazë të interesit u bë në datën 4 nëntor 2004.

muajit tetor, interesat mesatarë të ponderuar për depozitat tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë-mujore në lekë, arritën përkatësisht në nivelet 4.76 për qind, 5.63 për qind dhe 6.13 për qind.


Tabelë 9. Reagimi i sistemit bankar ndaj politikës monetare gjatë vitit 2004 (në pikë përqindjeje).

Periudha ⁸	30/12/03-28/04/04	28/04/-12/05/	12/05/-23/06/	23/06/-28/07/	28/07/-4/11/	04/11/03/12/	Total
Norma bazë e interesit	-0.5	-0.25	-0.25	-0.25	-0.25	-0.25	-1.75
Depozitat në lekë							
3-mujore	(0.45)	(0.03)	(0.29)	(0.07)	(0.13)	(0.17)	(1.14)
6-mujore	(0.52)	(0.15)	(0.34)	(0.08)	(0.49)	(0.02)	(1.60)
12-mujore	(0.54)	(0.14)	(0.45)	0.04	(0.47)	(0.13)	(1.69)
Yield-i i bonove të thesarit							
3-mujore	(0.28)	0.03	(0.21)	0.10	(0.61)	(0.17)	(1.14)
6-mujore	(0.42)	0.05	(0.22)	(0.08)	(0.79)	(0.05)	(1.50)
12-mujore	(0.27)	0.02	(0.24)	(0.02)	(0.71)	(0.18)	(1.40)

Sipas të dhënave operative, në tregun e depozitave në lekë, nuk kanë reaguar të gjitha bankat. Këtu ka ndikuar fakti se në total, ulja e interesave në afatet gjashtë dhe dymbëdhjetë-mujore, i është afruar uljes së sinjalizuar për vitin 2004. Gjithashtu, konkurrenca në tregun bankar është rritur si rezultat i çeljes së bankave të reja dhe i privatizimit të Bankës së Kursimeve.

Gjatë muajit tetor, interesat realë të depozitave dymbëdhjetë-mujore në lekë vazhduan të luhaten rreth një niveli mesatar prej 3.6 për qind, me një tendencë të lehtë rënëse. Këtu ka ndikuar, rritja e lehtë e inflacionit dhe ulja e interesave të depozitave në lekë duke ngushtuar diferencën midis tyre.

Grafik 12. Interesat realë dhe nominalë të depozitave me afat 12-mujor në lekë.




Në tregun primar, javën e parë të dhjetorit, *yield*-i mesatar i ponderuar i bonove të thesarit ra në 6.20 për qind, në 7.26 për qind dhe në 8.09 për qind, përkatësisht për afatet tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë-mujore. Këto janë nivelet më të ulta historike, të *yield*-it të bonove të thesarit të arritura në 10 vitet e funksionimit të këtij tregu. Ulja e *yield*-it të bonove të thesarit, ka ulur koston e borxhit të brendshëm të qeverisë. Nga ana tjetër, *spread*-i midis *yield*-it të bonove të thesarit dhe

⁸ Tregun periudhën midis dy vendimeve për ndryshimin e normës së bazë të interesit. Përfshin dhe fundin e vitit 2003, pasi efekti i vendimit të marrë në këtë periudhë është parë në fillim të vitit 2004.


interesit të depozitave në lekë, ka qenë i qëndrueshëm duke ndikuar në qëndrueshmërinë e të ardhurave të sistemit bankar.

Grafik 13. Ecuria e yield-it të bonove të thesarit.



Tregu ndërbankar është karakterizuar nga luhajtjet e normave të interesit brenda korridorit të lehtësive mbështetëse njëditore, duke reflektuar raportet e kërkesë-ofertës në treg. Në javën e parë të muajit dhjetor, interesat e transaksioneve një dhe shtatë-ditore arritën përkatësisht në nivelet 3.26 për qind dhe 5.9 për qind.

Grafik 14. Normat e interesit për transaksionet njëditore.




Në muajin tetor, interesat e kredive në lekë për të gjitha afatet kanë shënuar ulje, duke reaguuar në të njëjtin kah me sinjalet e politikës monetare.

Tabelë 10. Normat e interesit për kreditë në lekë (në përqindje).

	Shtator-04	Tetor-04	Ndryshimi (në pp)
Kredi deri 6 muaj	11.20	10.97	-0.23
Kredi 6 muaj – 1 vit	15.02	14.43	-0.58
Kredi 1 - 3 vjet	22.29	19.24	-3.05
Kredi mbi 3 vjet	14.56	11.69	-2.87


Gjatë muajit tetor, tërë banka kanë ulur interesat e kredive në lekë për afate të ndryshme, por nuk kanë munguar dhe rastet e rritjes së këtyre interesave.

Grafik 15. Interesat mesatarë të ponderuar të depozitave në valutë.



Në tregun e depozitave në valutë interesat mesatarë të ponderuar të depozitave me afat në usd dhe euro, arritën përkatësisht në 1.34 për qind dhe 1.66 për qind në fund të muajit tetor. Një muaj më parë, këta interesa rezultuan 1.15 për qind për depozitat në usd dhe 1.60 për qind për depozitat në euro. Normat e interesave në usd janë rritur në të gjitha afatet, ndikuar nga rritja e shpejtë e interesave libor, si pasojë e politikës shtrënguese të Fed-it. Interesat për depozitat tre dhe gjashtë mujore në euro janë ulur lehtë, por ato për depozitat një mujore, janë rritur duke ndikuar në uljen e interesit të ponderuar. Këtu kanë ndikuar luhatjet e interesave euribor si dhe konkurrenca në treg.

Grafik 16. Spread-i i interesave të depozitave me afat në lekë me ato në valutë.




Spread-i i interesave të depozitave me afat në lekë me ato në valutë ka ardhur duke u ngushtuar, duke rritur kështu preferencat për lekun. Në muajin tetor spread-i lekë-usd ka rënë në 3.8 për qind, dhe ai lekë-euro në 3.5 për qind. Kjo tendencë është mbështetur dhe nga inflacioni i ulët dhe mbiçmimi i lekut ndaj euros dhe dollarit.

IV.3 KURSI I KËMBIMIT

Tendenca e lekut për nënçmim ndaj euros dhe mbiçmim ndaj dollarit është vërejtur edhe gjatë periudhës tetor – nëntor 2004. Në fund të muajit nëntor, një euro është këmbyer me 128.19 lekë ndërsa një dollar është këmbyer me 96.97 lekë. Për periudhën tetor - nëntor leku është nënçmuar mesatarisht me 1.8 për qind kundrejt euros dhe është mbiçmuar mesatarisht me 4.1 për qind

kundrejt dollarit. Në terma vjetorë, leku rezulton i mbiçmuar kundrejt të dyja monedhave. Në nëntor, mbiçmimi është më i lartë kundrejt dollarit, rreth 14.9 për qind, ndërsa kundrejt euros masa e mbiçmimit është 5.7 për qind.

Grafik 17. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut kundrejt usd dhe euros.



Leku nuk ka shfaqur luhatje të forta në këmbimin kundrejt euros. Ndër faktorët e brendshëm që vazhdojnë të mbështesin ecurinë e lekut cilësohen përsëri niveli i ulët i inflacionit (pranë kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë), i cili ka rritur besimin në ruajtjen e vlerës së monedhës kombëtare, diferenca pozitive midis normës së interesave në lekë dhe atyre në valutë si dhe kërkesa e ulët e qeverisë për para. Nga ana tjetër, forcimi i euros kundrejt dollarit në tregun botëror është reflektuar në dobësimin e vazhdueshëm të dollarit kundrejt lekut. Këmbimi i euros mbi nivelin 1.3 dollarë është shoqëruar me rënien e dollarit edhe kundrejt lekut poshtë nivelit 96 lekë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.81, datë 28.12.2004

**PËR MIRATIMIN E "DOKUMENTIT TË POLITIKËS MONETARE
PËR VITIN 2005"**

Në mbështetje të nenit 43, shkronjat "a" dhe "ç" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë "Dokumentin e Politikës Monetare për vitin 2005", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij raporti në : Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

DOKUMENTI I POLITIKËS MONETARE PËR VITIN 2005

Hyrje

Banka e Shqipërisë, si autoriteti monetar i Republikës së Shqipërisë, është institucioni përgjegjës për hartimin, për miratimin dhe për zbatimin e politikës monetare. Politika monetare hartohet në funksion të përmbushjes së objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Politika monetare, së bashku me politikën fiskale, është një ndër politikat bazë makroekonomike. Ajo synon administrimin e variablave monetarë të ekonomisë – ofertën monetare dhe nivelin e normave të interesit – në funksion të arritjes së objektivit të stabilitetit të çmimeve në një periudhë afatmesme. Politika monetare realizohet nëpërmjet ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregjet financiare. Në tërësinë e saj, politika monetare përfshin: bazën ligjore në të cilën mbështetet; kuadrin e objektivave; aparatën teorik që përdoret për modelimin e saj; si dhe instrumentet e përdorura për zbatimin e saj. Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë dhe të publikojë parimet mbi të cilat do të bazohet hartimi dhe zbatimi i politikës monetare gjatë vitit në vazhdim. Duke u nisur nga rëndësia që ka kuptimi i drejtë i vendimeve të politikës monetare në publik, një pjesë integrale e politikës monetare janë edhe kanalet e komunikimit në publik të vendimeve të politikës monetare. Në këtë dokument jepet një përmbledhje e rrugëve kryesore të komunikimit, të përdorura nga Banka e Shqipërisë për komunikimin e politikës monetare.

Baza Ligjore

Në bazë të nenit 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë "... ka të drejtën ekskluzive të zbatimit të pavarur të politikës monetare".

Në bazë të nenit 3, pika 4a⁹, e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", ky institucion ka si detyrë kryesore "të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë në mënyrë të pavarur politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor".

Në bazë të nenit 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", si objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë përcaktohet "arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve".

Në bazë të nenit 43, pika a, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka këto kompetenca: "Të miratojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar kufijtë e operacioneve të Bankës së Shqipërisë në treg të hapur, përqindjen e interesave për depozitat në Bankën e Shqipërisë dhe për skontimet dhe huatë ose kreditë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të rezervave dhe nivelit të rezervave të detyruara, që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë bashkërendon politikën e saj monetare me nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe me strategjitë e hartuara për të. Në veçanti, një vëmendje e posaçme i kushtohet

⁹ Sipas amendamentit të bërë me ligjin nr. 8893, datë 25. 07. 2002.

bashkërendimit me politikën fiskale, si një përcaktuese tjetër e rëndësishme e zhvillimeve ekonomike në vend.

Në të njëjtën kohë dhe pa cënuar parimin e bashkërendimit të politikave ekonomike të vendit, miratimi i politikës monetare nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe zbatimi i saj me anë të instrumenteve monetare përcaktohen në mënyrë të pavarur nga Banka e Shqipërisë. Vendimet e politikës monetare nuk shkojnë në kundërshtim me nevojën e përmbushjes së objektivit të mandatuar nga ligji, arrijten dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

* * *

Konceptimi, hartimi dhe zbatimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë mbështeten në një kuptim të drejtë të rolit që mund të luajë politika monetare, nëpërmjet analizës së ndikimit të politikës monetare në ekonomi. Vlerësimi i këtij roli mbështetet si në mendimin teorik bashkëkohor, ashtu edhe në praktikën e huaj dhe shqiptare.

Roli i politikës monetare në zhvillimin ekonomik

Politika monetare synon të ndikojë variablat ekonomikë me anë të ndryshimit të normave afatshkurtra të interesit. Ajo përfshin të gjitha aspektet teorike, analizuese dhe operacionale të lidhura me këtë proces. Banka qendrore është në gjendje të ndikojë normat afatshkurtra të interesit në sajë të monopolit që i është njohur asaj për krijimin e parasë: parasë fizike dhe rezervave të bankave të nivelit të dytë.

Në periudhën afatshkurtër, një ndryshim i ofertës monetare apo i normave të interesit në tregun e parasë, vë në lëvizje një sërë mekanizmesh të cilët ndikojnë në tërësi aktivitetin ekonomik: prodhimin, punëzënien dhe nivelin e çmimeve. Ndërkohë, **në periudhën afatgjatë, do me thënë pasi në ekonomi të kenë ndodhur të gjitha ndryshimet dhe korrigjimet e sjelljes së agjentëve ekonomikë, ndryshimi në sasinë e parasë do të reflektohej vetëm në një ndryshim në nivelin e çmimeve, pa prekur variablat realë të ekonomisë: prodhimin, të ardhurat dhe punësimin.**

Nga ana tjetër, eksperiencia botërore dhe konsensusi i përgjithshëm i mendimit ekonomik sugjerojnë se luhatjet e nivelit të çmimeve, situatat inflacioniste apo deflacioniste, janë të dëmshme për ekonominë.

Stabiliteti i çmimeve nxit potencialin e rritjes së ekonomisë në periudha afatgjata nëpërmjet ndikimit pozitiv që ka në shpërndarjen e burimeve dhe në stabilitetin financiar të vendit.

Shpërndarja e burimeve dhe mirëqenia sociale.

Alokimi i burimeve në ekonomi, marrja e vendimeve për investime, prodhim dhe konsum varen nga çmimet relative të produkteve. Raportet e këtyre çmimeve japin një informacion të dobishëm në lidhje me produktet ose aktivitetet më fitimprurëse, duke orientuar më pas shpërndarjen e burimeve drejt tyre. Por, në një mjedis inflacionist, agjentët ekonomikë e kanë të vështirë të dallojnë një ndryshim në çmimet relative nga një rritje e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, pra nga inflacioni. Si rezultat, gjatë periudhave inflacioniste, faktorët e prodhimit

mund të drejtohen në përdorime të gabuara, duke iu shmangur shpërndarjes optimale të tyre.

Inflacioni vështirëson vlerësimin e normës reale të interesit, e cila udhëheq vendimet e individëve për konsum apo për kursim, dhe vendimet e firmave për investime. Për më tepër, luhatjet e normës së inflacionit bëjnë që kreditorët të kërkojnë një *prim inflacioni* për të kompensuar rrezikun e mbajtjes së vlerave nominale për periudha të gjata kohe. Duke reduktuar këtë rrezik, politika monetare ndikon pozitivisht në zgjerimin e ndërmjetësimit financiar dhe në rritjen e efektivitetit me të cilin tregjet financiare shpërndajnë burimet në ekonomi. Një situatë e tillë do të rezultojë në rritje të investimeve në ekonomi.

Inflacioni ndikon në rishpërndarjen e burimeve nga shtresat me të ardhura fikse (nëpunësit, pensionistët) tek ata me të ardhura të indeksuara me inflacionin (prodhuesit dhe tregtarët). Gjithashtu, në mungesë të një sistemi tatimor të indeksuar me inflacionin, ky i fundit mund të rezultojë në rritje jo të drejta të detyrimeve fiskale, duke zbehur nxitjen për investime dhe punë.

Stabiliteti financiar.

Stabiliteti financiar është i domosdoshëm për një ekonomi të shëndetshme. Ai rrit aftësitë e një ekonomie për të zbutur efektin e goditjeve të mundshme: rritjen e çmimeve të energjisë, ndryshime të theksuara teknologjike, zhvillime të paparashikuara në ekonominë e shteteve partnere në tregti, e kështu me radhë. Ngjarje të tilla sjellin keqpërdorim të burimeve, por një sistem financiar i shëndoshë mund t'i absorbojë këto goditje pa lejuar që ato të dëmtojnë aktivitetin ekonomik. Në këto rrethana, aktiviteti ekonomik do të ndikohej më pak nga ç' do të ndikohej në kushtet ku sektori financiar do të zmadhonte dhe përhapte efektet e goditjes. Një ekonomi me inflacion të ulët ka më pak të ngjarë të përjetojë luhatje të theksuara në çmimet e aseteve dhe në pritshmëritë për këto çmime. Problemet e lidhura me keqvlërësimin e çmimeve të aseteve financiare dhe parashikimet për to, janë afërsisht të njëjta me problemet e vlerësimit të ndryshimeve të çmimeve relative në prani të inflacionit, situatë kjo e përshkruar më sipër. Investitorët dhe kreditorët mund t'i keqintepretojnë sinjalet që marrin nga çmimet. Në këto rrethana, burimet financiare nuk shfrytëzohen siç duhet ose mbrojtja nga ky rrezik do të kërkonte një kosto shtesë financiare.

Duke u nisur nga argumentet e paraqitura më lart, Banka e Shqipërisë gjykon se ruajtja e stabilitetit të çmimeve përbën kontributin më të qenësishëm të saj në drejtim të përmbushjes së objektivave më të gjerë ekonomike: rritjes ekonomike dhe rritjes së standardit të jetesës.

OBJEKTIVI I INFLACIONIT PËR VITIN 2005

Në shërbim të transparencës dhe të rritjes së përgjegjshmërisë së saj, Banka e Shqipërisë është e interesuar të shpjegojë publikisht mandatin e saj, do me thënë interpretimin e stabilitetit të çmimeve. Ky proces i shërben orientimit të pritjeve të publikut drejt objektivit të inflacionit të

synuar. Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë informon edhe në lidhje me rrugët dhe instrumentet që do të përdorë Banka e Shqipërisë për arritjen e tij.

Të arrish stabilitetin e çmimeve do të thotë të arrish norma të ulëta pozitive të inflacionit ose të ndryshimit të çmimeve të konsumit. Të ruash stabilitetin e çmimeve do të thotë të sigurosh norma të ulëta pozitive inflacioni për periudha relativisht të gjata kohe.

Banka e Shqipërisë ka përcaktuar në strategjinë e saj trevjeçare "Plani i zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë (2003 - 2005)", objektivin e inflacionit për këtë periudhë. Objektivi strategjik afatmesëm i politikës monetare është mbajtja e inflacionit në nivele të ulëta pozitive të cilat sigurojnë qëndrueshmëri në tregje dhe mbështesin rritjen ekonomike.

Për të konkretizuar këtë angazhim, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë objektivin e inflacionit në formën e një bande, në intervalin 2 - 4 për qind për vitin 2005. Si objektivi i inflacionit vlerësohet rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit, matur dhe publikuar nga INSTAT.

Niveli i objektivit.

Ruajtja e inflacionit në nivele të ulta do të ketë një kontribut pozitiv në zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Së pari, duke qenë një normë pozitive inflacioni ajo mban parasysh evolucionin teknologjik të produkteve dhe përmirësimin cilësor të tyre. Gjithashtu, shumë studime kanë treguar se ecuria e inflacionit ka një prirje të brendshme statistikore për të rregjistruar vlera pozitive. Në realitet, një nivel inflacioni afër 0 mund t'i korrespondojë një situatë deflacioniste. Së dyti, norma e ulët e inflacionit ndihmon në ruajtjen e normave pozitive të interesit real. Normat reale pozitive të interesit ndihmojnë në thithjen e kursimeve të qytetarëve në sistemin bankar, duke ndikuar në stabilitetin e këtij të fundit dhe në ruajtjen e aftësisë së tij për të plotësuar nevojat e ekonomisë dhe të qeverisë për mjete monetare. Së treti, një normë e tillë inflacioni i përshtatet nevojave të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, si një ekonomi në tranzicion. Ajo lehtëson lëvizjen e çmimeve relative duke kontribuar pozitivisht në rolin informues që përmban ky mekanizëm në shpërndarjen e fondeve në ekonomi. Shumica e vendeve të zhvilluara e përkufizojnë stabilitetin e çmimeve si një nivel inflacioni rreth 2 për qind. Duke qenë se Shqipëria është një vend në tranzicion, një nivel më i lartë inflacioni reflekton një rrezik më të lartë strukturor të pranishëm në ekonominë shqiptare si dhe një lëvizje më të madhe të çmimeve relative në të. Së katërti, duke qenë në të njëjtin nivel me objektivin e inflacionit gjatë katër viteve të fundit, ai do të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e pritjeve inflacioniste në ekonomi dhe në rritjen e sigurisë në marrjen e vendimeve ekonomike. Nga ana tjetër, një nivel i tillë inflacioni dhe politika monetare e kërkuar për përmbushjen e tij ndikojnë pozitivisht në ritmet e rritjes ekonomike, ashtu siç është provuar gjatë viteve të fundit.

Forma e objektivit.

Objektivi i inflacionit për vitin 2005 do të jetë në formën e intervalit 2 - 4 për qind. Siç u parashtrua edhe më përpara, inflacioni është shpesh subjekt i veprimit të faktorëve të ofertës ose të rritjeve të administruara të çmimeve. Këto burime të lëvizjes së çmimeve janë jashtë ndikimit të politikës monetare. Megjithatë politika monetare është e vëmendshme edhe ndaj

këtyre faktorëve, ata nuk janë subjekt i ndërhyrjeve të vazhdueshme të politikës monetare. Për këtë arsye, përcaktimi i objektivit në formë intervali ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë afatmesme të politikës monetare.

Matje të tjera të inflacionit.

Banka e Shqipërisë, në funksion të rritjes së cilësisë së vendimmarrjes do të përdorë dhe matje të tjera të inflacionit. Këto matje krijojnë një bazë më të plotë për të marrë vendime sa më realiste. Kategoritë e tjera të inflacionit janë:

Inflacioni bazë. Banka e Shqipërisë do të punojë në vazhdimësi gjatë vitit 2005 për të ndërtuar serinë e inflacionit bazë dhe për të perfeksionuar metodologjinë e llogaritjes së tij. Me ndërtimin dhe testimin e kësaj serie, inflacioni bazë do të jetë një input i rëndësishëm në marrjen e vendimeve të politikës monetare.

Inflacioni vjetor në nivel mesatar. Kjo kategori përfaqëson nivelin mesatar të inflacionit vjetor për dymbëdhjetë muajt e fundit, duke dhënë një informacion të vlefshëm në lidhje me prirjet e zhvillimeve në çmimet e konsumit. Si i tillë, inflacioni vjetor në nivel mesatar do të jetë një orientues i rëndësishëm në procesin e marrjes së vendimeve të politikës monetare.

OBJEKTIVAT E NDËRMJETËM DHE OBJEKTIVAT OPERACIONALË

Kontrolli i inflacionit bazohet në kontrollin e treguesve të tjerë, të cilët, nga njëra anë, kanë lidhje të fortë me objektivin e inflacionit dhe, nga ana tjetër, janë nën një kontroll më direkt të Bankës së Shqipërisë. Këta janë objektivat e ndërmjetëm dhe operacionalë (sasiorë). Objektivat e ndërmjetëm janë orientues (tregues), ndërsa objektivat operacionalë ndiqen me rigorozitet. Këta objektiva, së bashku me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë, formojnë kuadrin e objektivave të saj.

Objektivi i ndërmjetëm për vitin 2005 është rritja vjetore e ofertës së parasë (M3). Përcaktimi i rritjes vjetore të M3 si objektiv i ndërmjetëm mbështetet në argumentin se inflacioni, duke qenë në përgjithësi fenomen monetar, ndikohet nga rritja në ofertën e parasë. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë synon të kontrollojë rritjen e mjeteve monetare në ekonomi në mënyrë që oferta e mjeteve monetare të korrespondojnë me nevojën e ekonomisë për mjete monetare reale. **Duke u nisur nga parashikimi i rritjes ekonomike për vitin 2005, nga objektivi i Bankës së Shqipërisë për nivelin e inflacionit, si dhe nga trendet e zhvillimeve monetare, Banka e Shqipërisë do të synojë të kontrollojë rritjen e ofertës monetare në nivelin 9.4 për qind për vitin 2005.**

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Vlera e lekut kundrejt valutave të huaja do të përcaktohet lirisht në tregun e këmbimit, në përgjigje të ligjeve të kërkesës dhe ofertës. Banka e Shqipërisë do të jetë e pranishme me ndërhyrje të veçanta në tregun valutor, duke synuar zbutjen e lëvizjeve afatshkurtra të kursit të këmbimit të lekut, të cilat janë në kundërshtim me prirjet afatgjata dhe respektimin e objektivit të rezervës ndërkombëtare neto.

Kuadri i objektivave të politikës monetare plotësohet me përcaktimin e objektivave operacionale të politikës monetare. Këta vendosin një lidhje më të ngushtë midis operacioneve të politikës monetare, objektivit të saj të ndërmjetëm dhe atij kryesor, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Objektivat operacionale për vitin 2005 janë mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë dhe rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë. Për secilin nga këta objektiva është vendosur një nivel sasior kundrejt të cilit kontrollohet puna e bërë për arritjen e tyre. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë, për efekte të politikës monetare, ndjek dhe monitoron edhe kreditin e brendshëm neto për qeverinë, ndonëse ky nuk është objektiv operacional i saj.

- **Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë** përfaqësojnë shumën e pretendimeve të Bankës së Shqipërisë, përjashtuar pretendimet valutore të saj ndaj jorzidentëve. Më konkretisht, këtu bëjnë pjesë pretendimet e Bankës së Shqipërisë ndaj Qeverisë (për neto) si dhe pretendimet e Bankës së Shqipërisë ndaj bankave të nivelit të dytë. Për to vendoset një kufi i sipërm, që do të thotë se Banka e Shqipërisë nuk mund të rrisë gjendjen e mjeteve të brendshme neto përtej shifrës së vendosur kufi.
- **Rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë** përfaqësojnë mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë minus të gjitha zotërimet valutore të bankave të nivelit të dytë të vendosura në Bankën e Shqipërisë (rezerva të detyrueshme në valutë plus rezervat e tepërta në valutë). Për to vendoset një kufi i poshtëm dhe përlogaritjet bazohen në kursin e këmbimit të fundit të muajit dhjetor të vitit 2003.
- **Kreditin e brendshëm neto për Qeverinë** përfaqëson totalin e pretendimeve të sistemit bankar ndaj qeverisë minus depozitat e kësaj të fundit si në Bankën e Shqipërisë ashtu dhe në bankat e nivelit të dytë. Vendosja e një niveli kufi të sipërm ka si synim të vërë nën kontroll, brenda niveleve të paracaktuara, kreditimin e deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar. **Për vitin 2005, kufiri i sipërm i financimit të brendshëm të deficitit buxhetor është 23.4 miliardë lekë.**

Këto nivele sasiore rishikohen gjatë vitit, në përputhje me ecurinë e zhvillimeve monetare dhe të masave korrektuese të propozuara nga Banka e Shqipërisë në programin monetar.

Në përputhje me zgjerimin dhe me rritjen e konkurrencës në tregun bankar shqiptar, Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë një rëndësi në rritje kontrollit të normave të interesit në tregun ndërbankar. Ndonëse ato nuk do të shërbejnë si një objektiv operacional i Bankës së Shqipërisë, normat e interesit të tregut ndërbankar janë një tregues i gjendjes monetare në ekonomi dhe një përcaktues i rëndësishëm i zhvillimit të ekonomisë.

INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Banka e Shqipërisë do të mbështetet në instrumentet indirekte të politikës monetare për të përmbushur objektivat e saj. Instrumentet e politikës monetare do të orientohen drejt përmbushjes së objektivave operacionale të Bankës së Shqipërisë. Në përputhje me parimet e

politikës monetare për vitin 2005, të përcaktuara më parë në këtë dokument, Banka e Shqipërisë nuk ka asnjë angazhim konkret në lidhje me ndërhyrjet në tregun valutor.

➤ **Operacionet e tregut të hapur¹⁰.**

Operacionet e tregut të hapur kanë për qëllim administrimin e normave të interesit në ekonomi, administrimin e gjendjes së likuiditetit në treg si dhe sinjalizimin e politikës monetare.

Operacionet e tregut të hapur përfshijnë:

- **marrëveshjet e riblerjeve dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve;**
- **transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota;**
- **operacionet në tregun valutor.**

Instrumenti kryesor që përdoret për të përçuar sinjalet e politikës monetare është norma e interesit që aplikohet në marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me afat njëjavor¹¹. **Norma e interesit e aplikuar nga Banka e Shqipërisë në këto operacione luan rolin e normës bazë të interesit në ekonomi.** Norma bazë e interesit vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe përdoret nga Banka e Shqipërisë në ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes (repove). Kjo normë përcakton edhe normën e interesit të depozitave dhe të huave njëditore të Bankës së Shqipërisë. Ajo ndikon normën e interesit të tregut ndërbankar, të depozitave në lekë pranë bankave tregtare si dhe të bonove të thesarit dhe të kredisë së akorduar në lekë për ekonominë.

➤ **Lehtësitë e përhershme.**

Lehtësitë e përhershme ndikojnë në gjendjen e likuiditetit në sistemin bankar dhe pengojnë luhatjet e mëdha të normave të interesit. Lehtësitë e përhershme realizohen gjithmonë dhe ekskluzivisht me nismën e bankave të nivelit të dytë. Palë e Bankës së Shqipërisë në këto operacione janë vetëm bankat e nivelit të dytë.

Lehtësitë e përhershme të ofruara nga Banka e Shqipërisë janë:

- **depozita njëditore;**
- **kredia njëditore;**
- **kredia Lombard.**

➤ **Rezerva e detyruar.**

Rezerva e detyruar është një instrument me anë të të cilit Banka e Shqipërisë i detyron bankat e nivelit të dytë, të vendosin një rezervë të caktuar në lekë dhe në valutë pranë saj. Nëpërmjet këtij instrumenti Banka e Shqipërisë synon në rregullimin e ofertës së parasë, të likuiditeteve dhe të normës së interesit në sistemin bankar si dhe në ruajtjen e sigurisë së sistemit.

¹⁰ Në fjalorin bashkëngjitur jepet një sqarim më i detajuar i funksionimit të instrumenteve monetare.

¹¹ Operacionet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes njihen respektivisht si repo dhe repo të anasjellta.

Banka e Shqipërisë, në varësi të kushteve të tregut financiar shqiptar dhe të nevojave të politikës monetare do të vazhdojë të rishikojë në vazhdimësi instrumentet e saj të politikës monetare gjatë vitit 2005. Këto rishikime do të bëhen me synimin e rritjes së eficiencës së përdorimit të tyre.

* *
*

KOMUNIKIMI I VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE.

Politika monetare dhe vendimet e marra në zbatim të saj i komunikohen publikut nëpërmjet këtyre dokumenteve:

- **Dokumenti i politikës monetare** që përshkruan parimet kryesore të kësaj politike të miratuar për një vit.
- **Deklarata e politikës monetare**, e cila përshkruan zhvillimet monetare në gjashtë muajt e kaluar dhe perspektivën për gjashtë muajt e ardhshëm.
- **Opinion mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit** ku jepen zhvillimet tremujore ekonomike dhe monetare.
- **Raporti Mujor i Politikës Monetare**, i cili përshkruan zhvillimet monetare mujore dhe jep vlerësimin mbi qëndrimin që duhet mbajtur në të ardhmen.
- Publikimi i **vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë** në lidhje me normat e interesit brenda 48 orëve nga marrja e vendimit.
- **Konferencat e shtypit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë** për të komunikuar dhe shpjeguar vendimet e politikës monetare.

Gjithashtu, komunikimi i politikës monetare realizohet edhe nëpërmjet publikimit të të gjitha **rregulloreve** dhe **akteve të tjera**, që kanë të bëjnë me instrumentet e përdorura për zbatimin e politikës monetare.

FJALOR

– **Marrëveshjet e riblerjes / të anasjellta të riblerjes.**

Këto marrëveshje përbëjnë një instrument me anë të të cilit Banka e Shqipërisë tërheq ose hedh *përkohësisht* likuiditet në sistemin bankar. **Marrëveshja e riblerjes** është një instrument që përdoret për të pakësuar *përkohësisht* likuiditetin në sistemin bankar. **Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes** përbën një instrument që përdoret për të shtuar *përkohësisht* likuiditetin në sistemin bankar ose aftësinë e bankave për të rritur kredidhënien apo për të rritur paratë në qarkullim. Marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve me afat njëjavor realizohen nëpërmjet **ankandeve standarde**. Ndërsa marrëveshjet me afat njëditor, njëmuajor dhe tremujor realizohen nëpërmjet **ankandeve të shpejta**.

– **Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota.**

Banka e Shqipërisë, pakëson likuiditetin në treg nëpërmjet transaksioneve të shitjeve me të drejta të plota dhe e shton atë nëpërmjet transaksioneve të blerjeve me të drejta të plota. Këto transaksione kryhen në formën e blerjeve apo të shitjeve të bonove të thesarit me afat maturimi deri një vit apo të letrave të borxhit me kredibilitet të lartë.

– **Operacionet në tregun valutor.**

Operacionet në tregun valutor kryhen nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet blerjes dhe shitjes së valutës në treg, kur ajo synon të veprojë në treg. Këto operacione kryhen në funksion të përmbushjes së politikës së përcaktuar në këtë Dokument.

– **Depozita njëditore.**

Depozita njëditore ndihmon bankat e nivelit të dytë të veprojnë me likuiditetin e tepërt, duke e depozituar atë vetëm për një ditë në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, depozita njëditore ndihmon në tërheqjen e likuiditetit të tepërt nga sistemi bankar dhe në zbutjen e luhatjeve të mëdha në normat afatshkurtra të interesit. Norma e interesit për depozitën njëditore përfaqëson normën më të ulët të interesit në treg, që ofrohet nga Banka e Shqipërisë.

– **Kredia njëditore.**

Kredia njëditore është një kredi plotësisht e garantuar, që akordohet për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të zgjidhin problemet njëditore të likuiditetit. Gjithashtu, ajo ndihmon për të zbutur luhatjet e normave afatshkurtra të interesit. Norma e interesit të kredisë njëditore është më e lartë se norma bazë e interesit.

– **Kredia Lombard.**

Kredia Lombard përdoret për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të kapërcejnë problemet e përkohshme të likuiditetit. Kjo është kredi plotësisht e garantuar me afat maturimi deri në tre muaj. Norma e interesit të kësaj kredie përfaqëson normën më të lartë të interesit të vendosur nga Banka e Shqipërisë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.84, datë 28.12. 2004

**PËR SHITESËN E DISA VEPRIMTARIVE TË LEJUARA PËR BANKËN
"RAIFFEISEN SH.A. "**

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" neni 12 shkronja (a), neni 43, shkronja (c) dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" neni 8, pika 2, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI :

1. Të miratojë shtesën e këtyre veprimtarive të lejuara në aneksin e licencës së Bankës "Raiffeisen", si më poshtë:
 - a) këmbimin e valutave duke përfshirë kontratat e së ardhmes (future) për këmbime valutore;
 - b) shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
 - c) shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
 - d) shërbime për nënshkrimin dhe për shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve, sipas kufizimeve të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".
2. Banka "Raiffeisen" të njoftojë Bankën e Shqipërisë për nisjen e operacioneve të përfshira në këtë licencë, si edhe të dërgojë kuadrin e brendshëm regullativ që përcakton mënyrën e kryerjes dhe të monitorimit të këtyre veprimtarive.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr.85, datë 28.12.2004

**PËR MIRATIMIN E "KALENDARIT TË MBLEDHJEVE DHE PROGRAMIT TË
PUNËS TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN
2005"**

Në mbështetje të nenit 43, pika (c) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë "Kalendarin e zhvillimit të mbledhjeve dhe programin e punës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2005", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me publikimin e "Kalendarit të zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2005".
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

KALENDARI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2005

NR	PROBLEMET KRYESORE, QË DO TË SHQYRTOHEN NË MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS	DATAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJES	DATAT E PUBLIKIMIT TË RENDIT DITËS
1	Deklarata e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2004.	26 janar 2005	24 janar 2005
2	Mbi ecurinë e tregjeve valutore dhe mbi ecurinë e tregjeve financiare ndërkombëtare.	9 shkurt 2005	7 shkurt 2005
3	Raporti i politikës monetare për muajin janar 2005.	23 shkurt 2005	21 shkurt 2005
4	Mbi ekzaminimet e kryera në bankat e nivelit dytë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004.	9 mars 2005	7 mars 2005
5	Miratimi i bilancit dhe Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004.	23 mars 2005	21 mars 2005
6	Analizë e sistemit bankar për tremujorin e katërt të vitit 2004.	13 prill 2005	11 prill 2005
7	Opinionimi i Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".	27 prill 2005	25 prill 2005
8	Mbi strukturën dhe gjendjen e monedhës në qarkullim në fillim dhe në fund të fitit 2005.	11 maj 2005	9 maj 2005
9	Raporti i politikës monetare për muajin prill 2005 dhe riishikimi i Programit Monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2005.	25 maj 2005	23 maj 2005
10	Raporti Vjetori i Mbikëqyrjes Bankare dhe mbi vlerësimin e rekomandimeve për pastrimin e parave nga bankat e nivelit të dytë.	8 qershor 2005	6 qershor 2005
11	Raporti i politikës monetare për muajin maj 2005.	22 Qershor 2005	20 qershor 2005

12	Analizë e sistemit bankar për tremujorin e parë të vitit 2005.	13 korrik 2005	11 korrik 2005
13	Deklarata e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005.	27 korrik 2005	25 korrik 2005
14	Raporti i politikës monetare për muajin korrik 2005.	24 gusht 2005	22 gusht 2005
15	Analizë e sistemit bankar për tremujorin e dytë të vitit 2005.	14 shtator 2005	12 shtator 2005
16	Raporti i politikës monetare për muajin gusht 2005.	28 shtator 2005	26 shtator 2005
17	Raporti i ekzaminimeve të kryera nga Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005 në bankat e nivelit dytë.	12 tetor 2005	10 tetor 2005
18	Opinionimi i Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2005".	26 tetor 2005	24 tetor 2005
19	Miratimi i Programit Monetar dhe i planit të buxhetit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006.	9 nëntor 2005	7 nëntor 2005
20	Raporti i politikës monetare për muajin tetor 2005.	23 nëntor 2005	20 nëntor 2005
21	Analizë e sistemit bankar për tremujorin e tretë të vitit 2005.	14 dhjetor 2005	12 dhjetor 2005
22	Raporti i politikës monetare për muajin nëntor 2005.	28 dhjetor 2005	26 dhjetor 2005

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004

1. Vendim nr.01, datë 28.01.2004 Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”.
2. Vendim nr.02, datë 28.01.2004 Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004 Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr.75, datë 25.09.2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004 Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SWIFT” miratuar me vendimin nr.16, datë 01.03.2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01.2004 Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004

1. Vendim nr.06, datë 11.02.2004 Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr.07, datë 11.02.2004 Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004

1. Vendim nr.08, datë 25.02.2004 Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004 Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr.10, datë 25.02.2004 Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

5. Vendim nr.12, datë 25.02.2004 "Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004 Për "Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo- Shqiptare".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004

1. Vendim nr.16, datë 10.03.2004 Për "Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare".
2. Vendim nr.17, datë 10.03.2004 "Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004

1. Vendim nr.20, datë 24.03.2004 Për miratimin e rregullores "Mbi kredinë brenda ditës".
2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës" miratuar me vendimin nr.57, date 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr.40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".
3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004 Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".
4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004 Për "Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 6, Prill 2004

1. Vendim nr.26, datë 14.04.2004 Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve.
2. Vendim nr.27 datë 14.04.2004 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 7, Prill 2004

1. Vendim nr.28, datë 28.04.2004 Për "Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes".

2. Vendim nr.29, datë 28.04.2004 Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi kredinë njëditore”.
3. Vendim nr.30, datë 28.04.2004 Për dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”.
4. Vendim nr.31, datë 28.04.2004 Për “Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 8, Maj 2004

1. Vendim nr.35, datë 12.05.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 9, Maj 2004

1. Vendim nr.36, datë 26.05.2004 Për miratimin e Raportit “Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.37, datë 26.05.2004 Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 përqind të aksioneve të kapitalit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare tek grupi financiar ICB HOLDING AG.
3. Vendim nr.38, datë 26.05.2004 Për miratimin e rregullores “Për adiministrimin e aktveve të qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë”.
4. Vendim nr.39, datë 26.05.2004 Për miratimin e rregullores “Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 10, Qershor 2004

1. Vendim nr.46, datë 09.06.2004 Për “Politikën e përdorimit të internetit dhe e-mail”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 11, Qershor 2004

1. Vendim nr.47, datë 18.06.2004 Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2004”.
2. Vendim nr.48, datë 18.06.2004 “Për disa ndryshime në rregulloren për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 12, Qershor 2004

1. Vendim nr.50, datë 23.06.2004 “Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.109, datë 24.12.2003 “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.
2. Vendim nr.51, datë 23.06.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 13, Korrik 2004

1. Vendim nr.52, datë 14.07.2004 Për “Administrimin e rrezikut të kredisë”.
2. Vendim nr.53, date 14.07.2004 Për “Shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, në vitin 2005”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 14, Korrik 2004

1. Vendim nr.56, datë 28.07.2004 Për “Miratimin e raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.57, datë 28.07.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes”.
3. Vendim nr.58, datë 28.07.2004 Për “Miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimin e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri””.
4. Vendim nr.59, datë 28.07.2004 Për “Lirimin nga detyra të Drejtorit aktual dhe emërimin e Drejtorit të ri të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 15, Gusht 2004

1. Vendim nr.60, datë 18.08.2004 Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin korrik të vitit 2004”.
2. Vendim nr.61, datë 18.08.2004 Për “Miratimin e transferimit të pronësisë së 100 përqind të aksioneve të kapitalit aksioner të bankës së kursimeve sh.a. nga Raiffeisen Zentralbank Österreich AG tek Raiffeisen International Bank-Holding AG.

3. Vendim nr.62, datë 18.08.2004 Për “Miratimin e rregullave të funksionimit të sistemit IDBS”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 16, Shtator 2004

1. Vendim nr.66, datë 22.09.2004 Për “Miratimin e raportit të politikës monetare për muajin gusht të vitit 2004”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 17, Nëntor 2004

1. Vendim nr.67, datë 04.11.2004 Për “Miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.68, datë 04.11.2004 Për “Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 18, Dhjetor 2004

1. Vendim nr.73, datë 24.11.2004 Për “Miratimin e Raportit të Politikës Monetare për muajin tetor të vitit 2004”.
2. Vendim nr.74, datë 24.11.2004 Për “Zgjedhjen dhe emërimin e Zëvendësguvernatorëve të Bankës së Shqipërisë”.
3. Vendim nr.75, datë 24.11.2004 Për “Miratimin e emërimit të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore e Juridik të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 19, Dhjetor 2004

1. Vendim nr.76, datë 08.12.2004 Për një ndryshim në rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare – AIPS.
2. Vendim nr.78, datë 08.12.2004 Për “Miratimin e kriterëve për caktimin e çmimeve të blerjes dhe të shitjes për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, ambalazhe dhe katalogë, si dhe të metodikës për llogaritjen e çmimeve të tyre”.